



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI

VENDIM

Nr. 158, datë 19.09.2024

PËR  
MIRATIMIN E SHOQËRISË “RSM ALBANIA” SH.P.K.,  
SI SHOQËRI AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE  
TË SHAFP E SIK “ALBSIG INVEST” SH.A.  
DHE FONDEVE QË ADMINISTROHEN PREJ SAJ

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 33 të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, nenit 35, të ligjit nr. 56/2020, si dhe të rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të SHAFP dhe SIK”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë “RSM Albania” sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë audituese për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të SHAFP e SIK “Albsig Invest” sh.a., dhe fondeve të pensionit vullnetar “Albsig” e “Smart Pension” dhe fondit të investimit “Albsig Standard”, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2024.
2. Ngarkohet Drejtorja e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI